REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:	2019:263023
Datë:	04.08.2021
Numri i dokumentit:	02061788

ARJ nr. 69/2021

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Muhamet Rexha, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në kontestin administrativ të paditësit ”K. M.”,sh.p.k., me seli në ...., të cilin sipas autorizimit i përfaqëson, avokat Blerim Xharavina nga .., kundër të padituri t Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit të padituri t, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA. Nr.99 /2021, të datës 19.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21 Korrik 2021, merr:

A K T GJ Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e paditësit, ”K, M.”,sh.p.k., me seli në ... e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë –Departamenti për Çështje Administrative, AA. Nr. 99/2021, të datës 19.04.2021.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA. Nr. 99/2021, të datës 19.04.2021, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit , ”K. M.”,sh.p.k., me seli në ...., ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A nr.988/2017, i datës, 21.12.2020.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të Gjykatës së Apelit, dhe aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi për mes të autorizuarit avokat Blerim Xharavina në afat ligjor në Gjykatë Supreme ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtëve për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes së të drejtës materiale. Propozon që kërkesa e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, i vërtetur me aktvendimin e

2021:130448

Gjykatës së Apelit të ndryshohet ashtu që duke e aprovuar kërkesë padinë e paditësit me të cilin është kundërshtuar si i pa bazuar vendimi i ATK -departamenti i ankesave me nr. Prot. .../2014, i dt. 11.06.2014 si dhe të obligohet ATK që menjëherë paditësit t'ia liroj-debllokoj xhirollogarinë bankare, ose të anulohet Aktvendimi i atakuar me kërkesë dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme në bazë të nenit 53 të LKA, ka mbajtur seancën e kolegjit, dhe pas vlerësimit të aktvendimeve të atakuara, kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshme të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA. Nr. 99/2021, të datës 19.04.2021, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit , "K. M.",sh.p.k., me seli në ..., ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A nr.988/2017, i datës, 21.12.2020, me të cilin është hedhë poshtë padia e paditësit me numër A nr.988/17, e dt. 12.06.2017, e plotësuar me datë 16.06.2017, si e pas afatshme.

Gjykata Supreme duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm pasi shqyrtoi aktvendimet e kontestuara si dhe shkresat e tjera të lëndës gjen se, gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë duke e refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallë së parë.

Qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta, si në aktvendimet e tyre si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykate ,nga se aktvendimet kontestuara me kërkesë nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës dhe as me shkelje të së drejtës materiale ashtu si pretendon paditësi në kërkesë.

Sipas nenit 27 par. 1, të Ligjit për Konflikte Administrative,(LKA),parashihet se padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës. Afatshmëria e paraqitjes së padisë vlerësohet sipas provave –shkresave të lëndës të cilat e vërtetojnë datën e dorëzim-pranimit të aktit i cili kontestohet me padi, si dhe datën e paraqitjes së padisë në gjykatë. Gjykatat e instanca më të në mënyrë të drejtë kanë vërtetuar faktet se, paditësi vendimin e të paditurit me nr. 176, të dt.11.06.2014, e ka pranuar me datë 22.03.2017, nga kjo datë në afat prej 30 ditë ka pas të drejtë të njëjtin ta atakoj me padi. Paditësi padi kundër të paditurës ka ushtruar me datë 12.06.2016, ndërsa plotësimin e padisë e ka bërë me datë 16.06.2017, kjo vërtetohet sipas datës së protokoluar me vulë pranimi të gjykatës. Nga kjo gjendje vërtetohet se padinë e ka ushtruar pas afatit të paraparë ligjor. Prandaj kjo gjykatë konstaton se gjykatat e instancave më të ulëta, në veçanti gjykata e shkallës së parë edhe pse në këtë çështje ka administruar prova shtesë lidhur me afatshmërinë e padisë, dhe pasi që as paditësi sipas ftesës së gjykatës nuk ishte në gjendje të ofroj prova të argumentuara se padia është e afatshme, me të drejtë dhe bazë ligjore nga neni 34 par.1, pika 1.1. të LKA-së, hedhet poshtë padia e paditësit si e paraqitur pas kalimit të afatit ligjor.

2021:130448

Paditësi në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në mes tjerash pretendon se, padinë e ka dorëzuar në afat ligjor në Postë me datë 03.04.2017, ose me 08.04.2017,dhe cila datë të merret si e saktë, me që nuk vërehet saktë vula, padia ishte e afatshme, se padinë nuk e ka dorëzuar Rekomande por në mënyrë të thjeshtë, se nga gjykata në seancën e mbajtur është obliguar që të siguroj dëshmi, ose nga posta për tu dëshmuar afatshmëria e padisë por posta nuk i ka ofruar prova me arsyetim se, ka kaluar afati i ruajtjes së dokumenteve(mbi 18 muaj), prandaj gjykata ka mundur ti ftoj në seancë zyrtarët e postës për tu verifikuar data e dorëzimit të padisë, se edhe gjykata e apelit ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës sepse nuk i ka vërtetuar pretendimet e paditësit në ankesë, etj. Kolegji i Gjykatës Supreme këto pretendime të paditësit dhe të tjerat si në kërkesë i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se, nuk janë të bazuara në fakte dhe prova juridikisht të vlefshme, andaj nuk janë me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje, sepse me asnjë provë paditësi nuk arrin të dëshmoj se padinë e ka dorëzuar në afatin e paraparë ligjor në gjykatë. E vetmja provë relevante dhe provuese është vula e pranimit të padisë në Gjykatë Themelore me datë 12.06.2017, nga vërtetohet se padia e paditësit është e pas afatshme, sepse vendimin e kontestuar të ATK-së, e ka pranuar me datë 22.03.2017. Nga paditësi nuk dëshmohet se padinë e ka dorëzuar me datë 03.04.2017, apo me datë 08.04.2017, ashtu si pretendon në postë në mënyrë të thjesht, kjo nuk dëshmohet as nga shërbimi postar. Gjer sa është fakt se gjykata e shkallës së parë ka ndërmarrë veprime procedurale të nevojshme ashtu si theksohet në aktvendimin e saj për tu provuar pretendimet e paditësit lidhur me afatshmërinë e padisë, fakte këto të shqyrtuara edhe nga gjykata e shkallë së dytë gjatë vendosjes sipas ankesës. Me që as paditësi dhe as Posta nuk kanë ofruar asnjë dëshmi për tu provuar afatshmëria e padisë, e po ashtu në Gjykatën e Apelit pala paditëse me ankesë nuk ka paraqitur asnjë provë relevante në këtë drejtim, andaj kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta pasi kanë vërtetuar në mënyrë të plotë çështjen në shqyrtim, duke respektuar në tërësi dispozitat ligjore dhe procedurale kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore si në aktvendimet e tyre.

Nga të cekurat si më lartë Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkallës së parë dhe e dytë në këtë çështje administrative juridike, drejtë kanë aplikuar dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Administratave, Ligjit për Konflikte Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore. Aktvendimet e kontestuar nuk janë të përfshirë me shkelje procedurale, apo me zbatim të gabuar të së drejtës materiale ashtu si theksohet në kërkesë të paditësit. Kjo gjykatë nuk gjen fakte se është cenuar ligji dhe e drejta materiale në dëm të palës paditëse. Vendimet e atakuara me kërkesë janë të qartë dhe të arsyetuar mjaftueshëm lidhur me faktet vendimtare të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë.

Nga sa u parashtrua si më lartë dhe në bazë të nenit 54 parag.1, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME- PRISHTINË
ARJ nr. 69/2021, me datë, 21 Korrik 2021

Procesmbajtës, Kryetari i Kolegjit,
Sherif Krasniqi Ragip Namani

2021:130448